Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/148
Datë: 19.03.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 15.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** Institucioni "B&M" SH.P.K me adresë: Rr. Gafurr Loku Nr. 36 në Paldenicë, Hani i Elezit, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 15.03.2024 deri 14.03.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **Operator i vinçave, ngritësve dhe të ngjashëm,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtar Profesional (D) me 4 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me katër (4) grupe trajnimi brenda një cikli të certifikimeve, me nga trembëdhjetë (13) kandidat/nxënës në një grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "B&M" SH.P.K ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të institucionit me kualifikimin: Operator i vinçave, ngritësve dhe të ngjashëm, Niveli III sipas KKK. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK.
AKK ka caktuar ekipin e eksperteve vlerësues të cilët me datë 07.11.2023 kanë analizuar dosjen e institucionit "B&M" SH.P.K, paneli i eksperteve me datë 10.11.2023 ka realizuar vizitën në këtë institucion për të bërë vlerësimin e procesit të validimit dhe akreditimit.

Paneli i eksperteve pas analizimit të dosjes dhe realizimit të vizitës tek institucioni, me datë 23.11.2023 ka përpiluar raportet vlerësuese për akreditim dhe validim për institucionit "B&M" SH.P.K. Ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 23.11.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv për institucionin dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim dhe validim si institucion ofrues, vlerësues dhe certifikues i kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në institucioni "B&M" SH.P.K si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës Institucioni "B&M" SH.P.K për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në Raportin e vlerësimit për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "B&M" SH.P.K

2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së